

Pjesëmarrja në Tryezën e Rrumbullakët për Organizmat Akredituese të Evropës Juglindore

9 Maj 2012, Beograd

I mbështetur nga projekti PTB, (Institutit Gjerman i Metrologjisë): "Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Evropën Juglindore në fushën e infrastrukturës së cilësisë", me datë 9 Maj 2012, në Beograd të Serbisë u mbajt takimi i Tryezës së Rrumbullakët. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i EA MAC komitetit, z. Thomas Facklam i cili me këtë rast edhe prezantoi temën:

Zgjidhjet e adoptuara për organet e rinj kombëtare të akreditimit, me një ekonomi të vogël dhe Marrëveshja Multilaterale me EA-në (Adopted solutions for new NAB- a small economy and the EA MLA). Takimi u vazhdua me vlerësimin e suksesit të trajnimeve të realizuara në Turqi, Maqedoni, Kroaci, Greqi, të cilat trajnime ishin të mbështetura nga projekti i PTB-së.

Gjithashtu në këtë takim u bënë planifikimet për aktivitete, trajnimet për vitin e ardhshëm, që do të u ofrohen organizmave të akreditimit.

Është me rëndësi të thuhet se gjatë këtij takimi kryetari i EA MAC komitetit, z. Thomas Facklam theksoi se DAK do ketë mbështetje profesionale me qëllim të forcimit të saj të mëtejshëm në aspektin e ngritjes së infrastrukturës së cilësisë për të arritur sa më shpejtë nënshkrimin e marrëveshjes multilaterale me EA-në.

Së fundi në këtë takim u vendos që takimi tjetër i radhës i Tryezës së Rrumbullakët për Organizmat Akredituese të Evropës Jug Lindore, të mbahet në Kroaci.